




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA DOGANORE BLLATË



Nr. 1421/4 Prot.

Bllatë, më 29 / 01 / 2024

Lënda: Kërkesë për njoftim publik

DREJTORISË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE

DREJTORISË SË PLANIFIKIMIT DHE ANALIZËS SË TË ARDHUARVE
Sektorit të Monitorimit të Borxhit

DREJTORISË SË BURIMEVE MBËSHTETËSE

TIRANË

Në zbatim të marrjes së masave për rikuperimin e borxhit doganor, mbështetur në Ligjin Nr.102/2014, datë 31.07.2014 « Kodi Doganor i Republiks së Shqipërisë », i ndryshuar, Udhëzimin nr.15, datë 03.12.2018 të DPD-së « Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës », kreu IV, pika 3/b, si dhe Ligjin nr.44/2015, datë 30.04.2015 « Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë » neni 162, pika 2 , kërkojmë kryerjen e njoftimit publik të vendimit nr.50, datë 29.12.2023 të Degës Doganore Bllatë (Peshkopi), të marrë ndaj shtetasit **Klodian Balliu me ID : I80628127U**, duke e publikuar në rubrikën « Njoftime » të faqes web të Institucionit.

Bashkëlidhur keni kopje të vendimit nr.50 , datë 29.12.2023, të Degës Doganore Bllatë dhe shkresën “Njoftim Vendimi”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

KRYETARI

Bajram KALIA

Adresa: Bllatë, Njësia Administrative Maqellarë, Bashkia Dibër



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA DOGANORE BLLATË

Nr. 1421/c Prot.

Bllatë, më 29. 12 . 2023

NJOFTIM VENDIMI BORXHI DOGANOR

Shtetasit Klodian BALLIU me ID: I80628127U

Adresa: Bashkia Bulqizë, Njësia Administrative Gjoricë, Fshati Gjoricë e Poshtme, rruga "Jella Ballie", numri i ndërtesës 25.

BULQIZË

Në zbatim të ligjit nr.102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

Ju njoftojmë se:

Në vijim të verifikimeve doganore të kryera lidhur me shkeljen doganore të kryer nga ana juaj më datë 17.01.2023, në vlerësimin e autoritetit doganor, rezulton se keni kryer shkeljen doganore të klasifikuar si kontrabandë,

Për këto arsye:

Me vendimin administrativ Nr. 50, datë 29.12.2023 të Degës Doganore Bllatë, shtetasi Klodian Balliu, është shpallur debitor për:

- shumën 59,319 lekë, penalitet

Sa më sipër, luteni që brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit të kryeni pagesën e shumës së mësipërme në bankat e nivelit të dytë sipas "Faturës për Arkëtim" që e keni bashkëlidhur këtij njoftimi.

Bashkëlidhur keni njw kopje tw kwtij vendimi.

KRYETAR

Bajram KALIA

Një kopje e kësaj letrë është dorëzuar më datë _____ pranë njësisë vendore ku subjekti ka selinë e tij.

<p>Firma e marrësit, ose në rastin e personit juridik, e përfaqësuesit</p>	<p>Marrësi nuk gjendet Shkresa e njoftimit iu dorëzua :</p> <p>Firma e _____ (Shënoni lidhjen e këtij personi me marrësin</p>	<p>Marrësi/personat e tjerë të përcaktuar nga ligji refuzojnë të nënshkruajnë.</p> <p>Nëpunësi që bën njoftimin/dëshmitari</p> <p>Nëpunësi që bën njoftimin/dëshmitari</p>
--	--	--

Adresa: Bllatë, Njësia Administrative Maqellarë , Bashkia Dibër



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
Dega Doganore Bllatë

Nr. 14Z1/1 Prot.

Bllatë, më 29. 12. 2023

V E N D I M Nr.50

Më datë 29.12.2023, unë, kryetari i Degës Doganore Bllatë, pasi shqyrtova procesverbalin nr.1201/2 prot., datë 30.11.2023, të mbajtur nga , Shpendi Kadriu me detyrë Përgjegjës i Zyrës së Operacioneve Doganore dhe Andon Lilo me detyrë Doganier Pikë Kontrolli/Peshore në Degën Doganore Bllatë, së bashku me dokumentacionin shoqërues, të mbajtur ndaj shtetasit Klodian Balliu me ID: I80628127U,

KONSTATOVA SE :

Më datë 17.01.2023 ora 15:30 në zonën doganore të Degës Doganore Bllatë në hyrje nga Maqedonia e Veriut për në territorin e Republikës së Shqipërisë shtetasi Klodian Balliu me mjetin me targë AB777XK gjatë kontrollit në vijë të parë të ushtruar nga punonjësi i policisë kufitare dhe punonjësi i doganës nuk ka pranuar të hapë bagazhin e mjetit për kontroll. Ndodhur në këto kushte punonjësit e doganës dhe policisë kanë kaluar mjetin për kontroll në vijë të dytë. Nga kontrolli i ushtruar në vijë të dytë u konstatua se në bagazhin e mjetit ishin 22 bidonë plastikë të mbushur me lëndë të dyshuar si naftë.

Sipas shkresës "Informacion për referimin e veprës penale në prokurori" të ardhur me shkresën nr.2774/1 prot., datë 15.11.2023 (protokolluar me tonën nr.1201/1, datë 20.11.2023) nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë me Juridiksion të Përgjithshëm Dibër, rezulton se shtetasi Klodian Balliu, i pyetur në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, ka deklaruar se naftën e ka blerë në Maqedoni dhe për të cilën ka paraqitur dhe faturën e blerjes. Për të gjitha veprimet e kryera nga punonjësit doganorë dhe policorë më datë 17.01.2023, janë mbajtur "raport shërbimi", "procesverbal për kapjen në flagrancë", ndërsa nga ana e punonjësve doganorë është mbajtur aktbllokimi i mallit (malli i bllokuar është dërguar në magazinën e Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër). Për këtë u është mbajtur procesverbali i verifikimit të kontrabandës nr.1201/2, datë 31.11.2023 i cili me shkresën nr.1330 prot., datë 05.12.2023 i është njoftuar shtetasit Klodian Balliu me anë të shërbimit postar dhe është konfirmuar marrja dijeni nga ana e tij.

Bazuar në ligjin nr.102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar neni 266 pika 2 dhe 267 pika 2; ligjit 61/2012 "Për akcizat në republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, nenet 46, 86; VKM nr.651, datë 10.11.2017 "Për dispozitat zbatuese të ligjit nr.102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, neni 443, veprimi i kryer nga shtetasi Klodian Balliu është një veprim për të shmangur kontrollin doganor dhe si i tillë, në vlerësimin e autoritetit doganor, përbën kontrabandë. Detyrimet doganore të papaguara për këtë sasi naftë janë në shumën 19,773 lekë.